

forcat serbe kishin bombarduar pyllin. Një granatë eksplodoi afër Azizës dhe e plagosi për vdekje në gjoks dhe këmbë, me ç' rast ajo edhe ndërroi jetë. Familjarët ishin të detyruar që të iknin përsëri. Trupi i Azizës qëndroi në pyll deri më 27.09.1998, kur djemtë e saj Xhevati, Aliu dhe Sylja i morën mbetjet mortore të së ëmës dhe i varrosën në varrezat e Gradicës/Gradica [Glllogoc/Glogovac]. Pas lufte, më 27.09.1999, i rivarrosën mbetjet mortore të Azizës në varreza në Hamidi/Hamidija.

Burimet: deklarata Xh.P, FDH-17593; ICTY, IT-05-87 (M.Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01434, FDH-33273.

Fikrije (Bejtë) Klinaku

(8.01.1998, shqiptare nga Bivolaku/Bivoljak, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn)

Në datën 22.09.1998, Fikrijen e vogël, me motrat e saj Arlinden dhe Durajeten, prindërit i nxorën nga fshati Bivolak/Bivoljak. Në traktor, me banorët e tjerë të fshatit, kishin shkuar në fshatin fqinj të Zhilivodës/Zilivoda. U strehuan në vendin e quajtur *Çezma e Gomurit/Çesma Gomura*, përmbi fshatin **Zhilivodë/Zilivoda** [bjeshta e *Çiçavicës/Čičavica*] dhe aty e kaluan natën. Në mëngjesin e datës **23.09.1998**, filloi granatimi. Njerëzit filluan të iknin dhe në rrëmujën e krijuar, babai i Fikrijes, Bejta, ishte ndarë nga familja. Një granatë kishte rënë afër traktorit të familjes Klinaku dhe e plagosi rëndë Fikrijen e vogël. Pjesëtarët e forcave serbe i morën me vete Fikrijen e plagosur, nënën e saj, motrat dhe dy kushërinj të plagosur rëndë. Me të arritur në Obiliq/Obilić, nëna i mori vajzat në shtëpinë e një miku të tyre, ndërsa të plagosurit, ushtarët i dërguan në spitalin e Prishtinës/Priština. Fikrija së shpejti ndërroi jetë. Po atë ditë, me të mësuar se Fikrija e vogël kishte pësuar, Bejta kishte shkuar në spitalin e Prishtinës/Priština dhe e kishte identifikuar Fikrijen. Duke e bartur në duar vajzën e vet të vdekur, kishte shkuar në Bivolak/Bivoljak, ku e ka varrosur po atë ditë. Në datën 14.08.2000, ekspertët ndërkombëtar i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Fikrijes dhe e kryen obduksionin në Institutin për

Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Më 26.09.2000, familjarët e rivarrosën Fikrijen e vogël në të njëjtin vend.

Burimet: deklarata B.K, FDH-29588; deklarata A.LI, FDH-38512; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, okto-bar-decembar 1998, 122, FDH-23857; *Serb Grenade Hits Refugee Tractor, 12-Year-Old Girl Dies, Several Wounded*, pasqyra e lajmeve, KIC, 25.09.1998, FDH-29571; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, Beograd, 2006, III,243.

Adriana (Nexhmedin) Klinaku

(27.03.1998, shqiptare nga Bivolaku/Bivoljak, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn)

Nexhmedini me bashkëshorten, të birin Fisnikun tetëmbëdhjetë muajsh, Adrianen gjashtëmuajshe dhe prindërit iu bashkuan vendasve, të cilët në mëngjesin e datës 22.09.1998 e braktisën fshatin Bivolak/Bivoljak. Ata kishin shkuar në fshatin fqinj të Zhilivodës/Zilivoda. Natën e kaluan në vendin e quajtur *Çezma e Gomurit/Çesma Gomura*, përmbi fshatin **Zhilivodë/Zilivoda** [bjeshta e *Çiçavicës/Čičavica*]. Natën e kaluan në traktorë. Në mëngjesin e datës **23.09.1998**, kur forcat serbe filluan granatimin e këtij vendi, familja ishte fshehur nën rimorkio. Adriana e vogël gjendej në djep. Një granatë kishte rënë në afërsi të tyre dhe e kishte plagosur gjyshin e saj. Së shpejti, në afërsi të traktorit ka eksploduar edhe një granatë tjetër. Ciflat e saj e qëlluan Adrianen në qafë dhe ajo së shpejti ndërroi jetë. Adriana është varrosur po atë ditë në varrezat në Obiliq/Obilić, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata M.K, FDH-29590; deklarata A.LI, FDH-38512; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 225.

Emin (Qazim) Jashanica

(5.10.1912, shqiptar nga Bivolaku/Bivoljak, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, pensionist, dymbëdhjetë fëmijë)

Emini i moshuar jetonte me bashkëshorten Rabijen dhe familjen e të birit Muharremit. Kur forcat serbe nisën t'i afroreshin fshatit më 22.09.1998, Emini me familje dhe banorët e tjerë kishin ikur në pyll, mbi